



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

protnumber

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

DHËNIE AUTORIZIMI DHE NDËRRIMIN E VENDNDODHJES SË DISA
QENDRAVE TË VOTIMIT NË AMBIENT PRIVAT, PËR ZGJEDHJET E KUVENDIT
TË DATËS 11 MAJ 2025

Në Nën mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 62, pika 4, nenit 93 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VËREN:

Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja, sipas përcaktimit të nenit 62, paragrafi 4, të Kodit Zgjedhor.

Për QV nr. 4421/01, QV nr. 4672/02 dhe QV nr. 4673/00 të qarkut Vlorë si dhe për QV nr. 2273/00 dhe QV nr. 2273/01 të qarkut Elbasan, nga bashkitë përkatëse janë depozituar brenda afatit për caktimin e vendndodhjes në ambient privat.

Në 2 (dy) qendra të votimit, konkretisht QV nr. 1959/03 në bashkinë Tiranë, qarku Tiranë, dhe QV nr. 2577/00 në bashkinë Belsh, qarku Elbasan janë ndryshuar ambientet private.

VENDOS:

1. Dhënien e autorizimit për ndërrimin e vendndodhjes së QV nr. 1959/03 nga mbienti privat në pronësi të shtetasit z. Kalosh Matranxhi, në ambientin privat në pronësi të z. Trifon Pergjegaj, Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë.
2. Dhënien e autorizimit për vendndodhjen e QV nr. 2273/00 në ambientin privat në pronësi të shtetasit z. Leonard Elezi, me adresë lagja Teqe, bashkia Peqin, qarku Elbasan.

Data: DD MM VVVV Nr: 00 00
Ora: HH:MM



Për dhënie autorizimi dhe ndërrimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në ambient privat, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025

3. Dhënien e autorizimit për vendndodhjen e QV nr. 2273/01 në ambientin privat në pronësi të shtetasit z. Leonard Elezi, me adresë lagja Teqe, bashkia Peqin, qarku Elbasan.
4. Dhënien e autorizimit për vendndodhjen e QV nr. 4421/01 në ambientin privat në pronësi të shtetasit z. Piro Subashi, me adresë Zvërnec, bashkia Vlorë, qarku Vlorë.
5. Dhënien e autorizimit për ndërrimin e vendndodhjes së QV nr. 4672/02 nga mbienti privat në pronësi të shtetasit z. Vasillaq Marto, në ambientin privat në pronësi të Jonica Konstruksion, Bashkia Sarandë, Qarku Vlorë.
6. Dhënien e autorizimit për ndërrimin e vendndodhjes së QV nr. 4673/00 nga mbienti privat në pronësi të shtetasit z. Pandi Dhima, në ambientin privat në pronësi të z. Pëllumb Sejdi, bashkia Sarandë, qarku Vlorë.
7. Dhënien e autorizimit për ndërrimin e vendndodhjes së QV nr. 2577/00 nga mbienti privat në pronësi të shtetasit z. Flori Idrizi, në ambientin privat në pronësi të z. Bajram Idrizi, njësia administrative Kajan, bashkia Belsh, qarku Elbasan.
8. Kryetari i bashkisë të afishojë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, sipas këtij vendimi.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI